



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.503/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli - kryesues, Hidajete Gashi-Alaj dhe Ramush Bardiqi- anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Subjektit Politik, Za Slabodu Pravdu i Opstanak dhe Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli ne Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik, Srpska Lista, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.02.2025, merr këtë:

VE N D I M

I. PRANOHEN të bazuar ankesat e subjektit politik Za Slabodu Pravdu i Opstanak, Anr.503/2025 të datës 09.02.2025, dhe Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli ne Prishtinë, Anr.537/2025 datës 10.02.2025

II. Subjektit politik Srpska Lista, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 5,000.00 Euro (pesëmijë) Euro.

III. Detyrohet Subjekti politik Srpska Lista, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 09.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr.503/2025 nga subjekti politik Za Slabodu Pravdu i Opstanak, në të cilën thekson se në ditën e zgjedhjeve, më 9 shkurt, kur ka pasur heshtje të plotë zgjedhore politike, kandidati për deputet nga Srpska Lista, Milan Kostiq, ka shkelur rregullin e heshtjes zgjedhore dhe ka promovuar përmbajtje promovionale zgjedhore politike në faqen e tij në Facebook, të publikuar rreth orës 14:00. Më tutje në ankesë ka theksuar se bazuar në dispozitat ligjore në fuqi lidhur me ciklin dhe rregullat zgjedhore, duke qenë se shkelja është bërë në datën 09.02.2025 rreth orës 14:00, ka kërkuar nga PZAP që ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe të merr vendim për ndëshkimin e subjektit politik Srpska Lista -Zlatan Elek në përputhje me normat dhe rregullat ligjore që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore.

Si provë ka bashkëngjitur postimin në facebook.

Me datë 10.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr.537/2025 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje me te cilën pretendon se më 9 shkurt 2025, z. Milan M. Kostić, kandidat i subjektit "Lista Srpska", ka postuar disa herë në rrjetin Facebook lidhur me zgjedhjet (në faqen e vet: fb.com/MilanMimaKostic). Në orën 1 3: 13 ka postuar një imazh ku shfaqet portreti i z. Kostiq dhe fletëvotimi me numra të shënjuar për subjektin dhe kandidatët e tij, ndërsa në përshkrimin (diçiturën) e imazhit thuhet: "Svi za DRŽAVU SRBIJU SRPSKA LISTA a 112", që shqip domethënë "Të gjithë për SHTETIN E SERBISË UJ LISTA SERBE 112". Kandidati qartazi ka bërë fushatë, duke cekur emrin dhe numrin në fletëvotim të subjektit si dhe numrat e kandidatëve. Kandidati gjithashtu ka përdorur gjuhë nxitëse e provokuese që ngjall urrejtje ose dhunë, duke mohuar sovranitetin e Republikës së Kosovës dhe duke avokuar për rikthimin e shtetit të Serbisë në Kosovë. Provë:Pamje e ekranit me postimin e z. Kostiq (bashkëngjitur) 2) Postimi i z. Kostić në Facebook, <https://shorturl.at/UtUu> Paraprakisht, në orën 8:54, ka postuar fotografi nga qendra e votimit, me përshkrimin ' Tako se brani Sveta zemlja Kosovo i Metohija V RS' (serbisht: "Kështu mbrohet toka e shenjtë Kosovë-Metohi"). Kështu z. Kostić ka përdorur emërtimin kolonial dhe shovenist serb për Kosovën, çka përbën gjuhë nxitëse e provokuese ndaj komuniteteve që jetojnë në Republikën e Kosovës. Për më tepër, z. Kostić ka përdorur edhe flamurin shtetëror të Serbisë (për dallim nga flamuri popullor serb). Flamuri i Serbisë, që vazhdon të mbajë pretendime territoriale mbi Kosovën, është përdorur si simbol kundër sovranitetit të Republikës së Kosovës. Provë:1) Pamje e ekranit me postimin e z. Kostić (bashkëngjitur) 2) Postimi i z. Kostić në Facebook, <https://shorturl.at/6bEZG>. Postimet janë bërë ditën e zgjedhjeve dhe gjatë kohës sa qendrat e votimit kanë qenë të hapura. Kështu z. Kostiq ka bërë fushatë gjatë kohës sa qendrat e votimit kanë qenë të hapura, çka ndalohej me nenin 37.1.2 të LZP-së. Z. Kostiq gjithashtu ka shfrytëzuar rrjetet sociale me qëllim të ndikimit tek votuesi, në kundërshtim me nenin 8.1.5 të Rregullores (KQZ) nr. 07/2024 për fushatën e zgjedhjeve, monitorimin e fushatës së zgjedhjeve dhe deklarinimin financiar. Në të gjitha rastet, z. Kostiq ka përdorur gjuhë nxitëse e provokuese kundër komuniteteve që jetojnë në Republikën e Kosovës, çka ndalohej me nenin 35.4 lidhur përshtatshëmrisht me nenin 34.1.11 të LZP-së.

Në përgjigjen në ankesë për ankesën Anr 537/2025 të subjektit politik Srpska Lista theksohet se materiali i publikuar është postuar në profilin privat të kandidatit në Facebook, i cili nuk është profili zyrtar i partisë, kandidati përdori profilin e tij personal dhe personat që e panë këtë postimin ishin miqtë e tij në rrjetin social, të cilët vendosën ta ndiqnin vetë dhe që kishin akses në përmbajtjen e tij në atë moment. Më tutje në përgjigje në ankesë ka theksuar se partia jonë asnjëherë nuk e ka pasur ndërmend të ndikoj tek votuesit gjatë asaj periudhe dhe postimi u hoq menjëherë sapo e vumë re keqkuptimin. Ju sigurojmë se do të marrim masa shtesë në të ardhmen për të shmangur situata të ngjashme dhe për të siguruar respektimin e plotë të legjislacionit dhe i ka propozuar PZAP-it që ta aprovojë përgjigjen në ankesë dhe ta refuzojë ankesën.

Në përgjigjen në ankesë për ankesën Anr 537/2025 të subjektit politik Srpska Lista theksohet se duke qenë se kjo ankesë ka të bëjë me të njëjtën çështje për të cilën tashmë kemi pranuar ankesa nga subjekti politik Për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë në ankesën Anr.503-2025 dhe duke pasur parasysh se të dyja rastet përfshijnë të njëjtat arsye, të njëjtat rrethana dhe të njëjtat prova, ju kërkohet që ta refuzoni këtë ankim të dytë si përsëritje të një ankimi

ekzistues, sepse si i tillë përbën shkelje të parimit “ne bis in idem”, i cili ndalon përsëritjen e procedimeve në të njëjtën çështje.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr. 01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi I të Ligjit Nr. 05/1,-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si ne vijim: Anr.503/2025, dhe të datës 09.02.2025, dhe Anr.537/2025, të datës 10.02.2025 janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë e përbashkët Anr.503/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara kundër subjektit të njëjtë politik Lista Serbe si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

Ankesat janë të bazuara

Paneli, pas shikimit shkresave të lëndës të ofruar si provë materiale nga subjekti politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak dhe Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ka gjetur se Kandidati për deputet i subjektit politik Srpska Lista, me qëllim të bërjes së fushatës zgjedhore dhe me qëllim të promovimit të subjektit politik Srpska Lista dhe veten gjatë ditës së votimit ka bërë thirrje që të votohet subjekti politik Srpska Lista me numër 112 dhe kandidatet e saj dhe veten, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 37 paragrafi 1 dhe 2 i LZP-së ku përcaktohet se “1. Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohej secili prej veprimeve si më poshtë: shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, dhe oborri i së njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi të votuesit; bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”, andaj Paneli gjeti se veprimet e tilla janë në kundërshtim me dispozitat e nenit 37 LZP-së ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike dhe nga këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 37 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të LZP-së.

Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik Srpska lista, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, ku nga kjo përgjigje ky subjekt thekson se “Materiali i publikuar është postuar në profilin privat të kandidatit në Facebook, i cili nuk është profili zyrtar i partisë. Kandidati përdori profilin e tij personal dhe personat që e panë këtë postimin ishin miqtë e tij në rrjetin social, të cilët vendosën ta ndiqnin vetë dhe që kishin akses në përmbajtjen e tij në atë moment”, për Panelin pretendimet e parashtruara në përgjigje në ankesë janë të pa bazuara për faktin se personi i cekur në ankesë është kandidat për deputet i subjektit politik në fjalë ashtu siç është përcaktuar në Ligjin e Zgjedhjeve në Republikën e Kosovës, andaj paneli i mori për bazë pretendimet ankimore të palës ankuese sa i përket personit të lartcekur.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë pasi që është kandidat për deputet, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjektit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se subjekti politik Srpska lista, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë ditës së votimit, që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Paneli me rastin e marrjes së vendimit për lartësinë e gjobës ka vlerësuar rrethanë lehtësuese faktin që Kandidati për deputet i subjektit politik në fjalë ka bërë largimin e postimit në rrjetin social facebook.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nënin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.503/2025, datë 12.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së.